

# PLANI I VEPRIMIT

## 2026

### Federata e Basketbollit të Kosovës

16 Mars 2026,  
Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com  
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria  
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

## PËRMBAJTJA

Për Federatën e Basketbollit të Kosovës .....	3
Qëllimet e përgjithshme të Federatës së Basketbollit të Kosovës.....	5
Hyrje në Planin e Veprimit 2026.....	6
Grupet e interesit.....	7
Swot Analiza .....	8
Prioritetet Strategjike të FBK-së për 2026 .....	11
Objektivat Strategjike.....	12
1.Garat e FBK-së.....	15
2. Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës .....	16
3. Klubet dhe anëtarët e saj .....	17
4. Organizimi i eventeve dhe aktivitetet tjera .....	18
5.Aktivitetet e basketbollit 3x3 .....	19
6.Aktivitetet për trajnerët.....	20
7.Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues.....	21
8. Projektet zhvillimore .....	23
9.Ngritja e kapaciteteve njerëzore .....	25
10.Diplomacia sportive.....	26
11.Aktet normative të FBK-së .....	27
Rekomandimet.....	29
Përfundim.....	30

## PËR FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) përfaqëson një nga institucionet më të rëndësishme sportive në vend, si nga aspekti i organizimit ashtu edhe nga ndikimi i saj në zhvillimin e basketbollit. Me një traditë të konsoliduar dhe rol të qartë strategjik, FBK njihet si një nga federatat më të mëdha dhe më aktive në Kosovë. E vlerësuar gjerësisht për transparencë, profesionalizëm dhe efikasitet organizativ, FBK është pozicionuar si federata më e organizuar sportive në vend, duke vendosur standarde të larta në menaxhim, administrim dhe zbatim të politikave sportive. Përmes programeve, investimeve dhe vizionit të saj afatgjatë, Federata vazhdon të kontribuojë në rritjen e komunitetit të basketbollit, zhvillimin e talenteve të rinj dhe forcimin e përfaqësimit ndërkombëtar.

Që nga viti 1999, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vazhduar të ndërtojë dhe fuqizojë strukturat e basketbollit në të gjitha nivelet, duke promovuar talente të reja dhe duke kultivuar pasionin që e karakterizon këtë sport. Rrënjët e basketbollit në Kosovë datojnë që nga viti 1945, periudhë në të cilën u hapën themelet e këtij sporti dhe u krijua tradita që sot përbën një trashëgimi të rëndësishme sportive dhe kulturore në vend. Një moment historik për FBK mbetet viti 2015, kur Federata u pranua zyrtarisht me të drejta të plota në FIBA, duke i mundësuar Kosovës përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e rregullt në arenën ndërkombëtare të basketbollit. Ky hap konfirmoi jo vetëm përparimin institucional të Federatës, por edhe rëndësinë e basketbollit kosovar në skenën globale.

FBK në gjirin e saj i ka rreth 150 klube, prej tyre rreth 122 marrin pjesë në garat e kategorive të kategorive të reja (U-10, U12, U14, U16, U18) në të dyja konkurrencat (djem e vajza).

FBK organizon nën ombrellën e saj 19 liga të rregullta të kategorive të ndryshme, gara shkollore, ligën Junior NBA, gara elitare në disiplinën 3x3, ligën e veteranëve, si dhe gara për të punësuarit, dhe ka të regjistruar afro 2500 basketbolliste e basketbollistë. Krahas garave kampionale, FBK organizon garat e Kupës së Republikës për të gjitha grupmoshat dhe gjinitë. Është bashkëthemeluese dhe organizatore e Ligës Unike – si ligë e parë sportive mbarëkombëtare e organizuar me Federatën Shqiptare të Basketbollit (FSHB). Gjatë secilit edicion garues, FBK organizon rreth 1500 ndeshje në të dyja konkurrencat (meshkuj e femra) dhe për të gjitha grupmoshat.

Krahas organizimit dhe drejtimit të garave në nivel kombëtar dhe mbarëkombëtar, që nga pranimi në FIBA në vitin 2015, FBK ka paraqitur për gara dhe përfaqësuar Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet e garimit dhe kategoritë në të cilat ka të drejtë të marrë pjesë, përfshirë përfaqësueset U14, U16, U18 dhe U20 vajza dhe djem, përfaqësueset seniore të të dyja gjinive në basketboll dhe përfaqësuesen seniore të të dyja gjinive në disiplinën 3x3 si dhe në e-FIBA.

Që nga viti 2018, çdo verë FBK organizon Kampionate Evropiane të FIBA-s për grupmoshat e reja, ndërsa në vitin 2022, dhe 2023 ka organizuar edhe garat prestigjioze të FIBA 3x3 Challenger Prishtina, FIBA Ligës së Kombeve 3x3 dhe FIBA Kampionatit Evropian U23, ndërsa për dy vite rresht (2024 dhe 2025) FBK është nikoqire e FIBA 3x3 EuroCup Qualifiers, FIBA 3x3 Challenger Prishtina, FIBA 3x3 Women's Series.

Viti 2026 do të shënojë një kapitull të rëndësishëm për basketbollin në Kosovë, me organizimin e tri ngjarjeve ndërkombëtare të profilit të lartë:

- FIBA 3x3 EuroCup Qualifiers
- FIBA Women's European Championship për Shtetet e Vogla
- FIBA U18 Women's EuroBasket, Divizioni C

Këto aktivitete përfaqësojnë një mundësi unike për të promovuar basketbollin kosovar në arenën ndërkombëtare dhe për të forcuar pozicionin e vendit tonë si një destinacion i rëndësishëm për sportet e basketbollit.

Federata e Basketbollit e Kosovës është pjesë e programeve edukative e zhvillimore, siç janë FIBA TIME OUT Program, MESGO – The Executive Master in Global Sport Governance, FIBA Academy Strategic Leaders, FECC, FIBA Europe Girls Program, FIBA Youth Development Program, Alley Oop, FIBA Europe Women in Leadership, FIBA U14 Get Together, ASMC etj.

FBK ka të punësuar 16 persona dhe do të vazhdoj të angazhojë edhe punonjës tjerë në të ardhmen për të zbatuar projekte e programe të tjera në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kryetari i FBK-së mban postin e Anëtarit të Bordit Ekzekutiv të FIBA Europe si dhe Nënkryetarit të Komisionit për të Rinj për mandatin 2023-27. Ai gjithashtu është edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), ndërsa Sekretarja e Përgjithshme e FBK është anëtare e Komisionit të FIBA Botës 3x3 për mandatin 2023-2027 dhe të Komisionit të FIBA Europe për Komisioni për Zhvillimin e Biznesit për mandatin 2025-2027.

FBK është federata e parë sportive në vend që ka miratuar Planin Strategjik për periudhën 2021-25, duke krijuar bazën afatmesme për zhvillimin e federatës dhe komunitetit të basketbollit në vend. Në këtë dokument strategjik, të cilin e ka hartuar dhe miratuar gjatë kohës së pandemisë kur aktivitetet sportive në vendin tonë ishin pezulluar në bashkëpunim të ngushtë me FIBA (si federata e parë e basketbollit në botë që ka përfitur nga granti i FIBA Plus), FBK ka përcaktuar misionin e saj për rritjen, zhvillimin dhe qeverisjen e mirë të basketbollit në Kosovë, nën vizionin që të bëhemi dhe mbesim sporti më i dashur në vend, duke iu përmbajtur dhe duke i avancuar më tej vlerat e veta: respektin, zellin, vizionin, pasionin dhe përkushtimin për fitore.

Gjatë këtij viti, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), në mënyrë intensive dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit dhe ekspertët e FIBA Plus, ka punuar në hartimin e Planit Strategjik për pesë vitet e ardhshme, për periudhën 2026-2030, me fokus në pesë qëllime kryesore:

- Të krijohet një sistem i qëndrueshëm i edukimit të trajnerëve
- Të zgjerohet komuniteti i basketbollit
- Të rritet pjesëmarrja e vajzave dhe grave në basketboll
- Të fuqizohen Përfaqësueset e Kosovës
- Të hartohet një program i zhvillimit të talenteve

Duke marrë parasysh se Kosova do të jetë nikoqire e Lojërave Mesdhetare 2030, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka nisur që nga ky vit përpjekjet për fuqizimin e disiplinës 3x3. Në këtë kuadër, është hartuar Strategjia e Zhvillimit të Basketbollit 3x3, me qëllim përgatitjen dhe zhvillimin e Përfaqësueseve të Kosovës për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.

Plani i Veprimit 2026 është hartuar në përputhje të plotë me Planin Strategjik të FBK-së 2026–2030, duke reflektuar objektivat dhe prioritetet e përcaktuara për zhvillimin e basketbollit në vend. Në këtë kontekst, ai është i lidhur ngushtë edhe me Strategjinë e Zhvillimit të Basketbollit 3x3 drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, e cila synon të forcojë këtë disiplinë. Ky koordinim siguron që të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e planifikuara për vitin 2026 të jenë të integruara me vizionin afatgjatë të Federatës dhe objektivat strategjike të saj.

## QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË FEDERATËS SE BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

- **Performanca e lartë** – zbatimi i planeve dhe detyrave të caktuara, përfshin planin teknik, zhvillimin e lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve si dhe organizimin dhe zhvillimin e garave.
- **Rritja e të ardhurave dhe stabiliteti financiar** – sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare për zhvillimin e sportit dhe menaxhimin e federatës.
- **Basketbolli për të gjithë** – rritje 100% e pjesëmarrjes përmes komunitetit, klubeve dhe shkollave, duke u fokusuar në përfshirjen e të gjitha grupmoshave.
- **Vajzat dhe gratë në basketboll** – promovimi i pjesëmarrjes dhe zhvillimit të grave dhe vajzave në të gjitha nivelet e sportit.

- **Fuqizimi i klubeve tona** – mbështetje e organizimit, kapaciteteve dhe zhvillimit të klubeve anëtare të FBK-së.
- **Infrastruktura dhe ambienti sportiv** – investime në palestra, terrene dhe ambiente të përshtatshme për stërvitje dhe gara nëpërmjet Qeverisë Qendrore dhe atyre lokale.
- **Marketingu dhe promovimi i sportit** – forcimi i imazhit të basketbollit, komunikimi me publikun dhe mediat sociale, zhvillimi i sponsorizimeve strategjike.
- **Zhvillimi i teknologjisë dhe inovacionit** – zbatimi i platformës për shitjen e biletave online.
- **Shëndeti dhe mirëqenia e sportistëve** – trajtime mjekësore, psikologji sportive, programet anti-doping dhe menaxhimi i lëndimeve.
- **Zbatimi i politikave të mbrojtjes** – implementimi i masave dhe politikave të dala nga projekti Safeguarding the Future, për sigurinë dhe mbrojtjen e të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetet e basketbollit.
- **Përfaqësimi ndërkombëtar dhe diplomacia sportive** – pjesëmarrja në gara dhe evente ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi me federata dhe organizata të tjera sportive.
- **Edukimi i komunitetit** – seminare edukative për trajnerë, gjyqtarë dhe zyrtarë sportivë.
- **Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia sociale** – iniciativat për komunitet, basketbollin për të rinj në zona të pazhvilluara/rurale, aktivitete humanitare dhe promovimi i vlerave pozitive të sportit.

---

## HYRJE NË PLANIN E VEPRIMIT 2026

---

Plani i Veprimit 2026 i Federatës së Basketbollit të Kosovës është një udhërrëfyes strategjik që përcakton objektivat kryesore për zhvillimin e basketbollit në vend gjatë këtij viti. Bazuar në Planin Strategjik 2026–2030 si dhe Strategjia e zhvillimit të basketbollit 3x3 drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 plani synon të strukturojë aktivitetet, të përcaktojë objektivat strategjike dhe të mundësojë matjen e rezultateve përmes indikatorëve të performancës.

FBK, si një nga institucionet më të rëndësishme sportive në Kosovë, ka planifikuar një kalendar të pasur për vitin 2026, që përfshin gara vendore dhe ndërkombëtare, projekte zhvillimore dhe përfaqësime të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Këto aktivitete kërkojnë burime të konsiderueshme financiare dhe organizative, duke reflektuar përkushtimin e FBK-së për zhvillimin e basketbollit në të gjitha nivelet.

## Plani i Veprimit synon realizimin e qëllimeve kryesore strategjike të FBK-së, duke përfshirë:

- Përmirësimin e performancës së Përfaqësueseve dhe zhvillimin e lojtarëve dhe trajnerëve.
- Rritjen e pjesëmarrjes dhe përfshirjes, veçanërisht të vajzave dhe grave.
- Fuqizimin e klubeve dhe promovimin e qeverisjes së mirë.
- Modernizimin e proceseve dhe avancimin e digjitalizimit, përfshirë zbatimin e platformave online.
- Zbatimin e politikave të mbrojtjes dhe iniciativave të përgjegjesisë sociale.

Implementimi i këtij plani është përgjegjësi e përbashkët e Bordit të FBK-së, të kryesuar nga Kryetari, dhe Zyrës Ekzekutive, të drejtuar nga Sekretarja e Përgjithshme, në bashkëpunim me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore, FIBA-n dhe partnerët privatë.

Plani gjithashtu parashikon monitorimin dhe vlerësimin e progresit në mënyrë të rregullt, duke siguruar një qasje të bazuar në të dhëna për të përshtatur strategjitë dhe për të arritur objektivat e vitit 2026. Ky angazhim i përbashkët synon jo vetëm realizimin e rezultateve vjetore, por edhe ndërtimin e një baze të fortë për avancimin e mëtejshëm të basketbollit në Kosovë.

---

## GRUPET E INTERESIT

---

Federata e Basketbollit të Kosovës bashkëpunon me një rrjet të gjerë palësh të interesit, të cilët kanë një rol thelbësor në arritjen e objektivave strategjike dhe zhvillimin e sportit në të gjitha nivelet.

### Këto grupe përfshijnë:

- **Kuvendi i FBK-së** – organi më i lartë vendimmarrës.
- **Bordi Ekzekutiv dhe Zyra Ekzekutive e FBK-së** – përgjegjës për vendimmarrjen dhe zbatimin e aktiviteteve.
- **Klubet e basketbollit** – aktorët kryesorë të zhvillimit të sportit dhe bazë e komunitetit të basketbollit.
- **Komisionet e FBK-së** – përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e garave dhe aktiviteteve.
- **Përfaqësueset, basketbollistët/et, trajnerët/et dhe gjyqtarët/et** – që përfaqësojnë bazën e komunitetit dhe kontribuojnë direkt në performancë.
- **Komitetet Lokale Organizative** – që luajnë rol të rëndësishëm në organizimin e eventeve dhe ngjarjeve sportive.

- **Ambasadorët e basketbollit të Kosovës** – promovojnë sportin dhe vizionin e FBK-së.
- **Institucionet shtetërore dhe komunale** – mbështesin zhvillimin përmes burimeve dhe politikave.
- **Partnerët ndërkombëtarë** – përfshirë FIBA-n, federatat nacionale dhe organizatat sportive ndërkombëtare.
- **Partnerët medial dhe sponsorët** – kontribuojnë në rritjen e vizibilitetit dhe burimeve financiare.
- **Shoqatat e komunitetit dhe organizatat joqeveritare** – promovojnë sportin, përfshirjen sociale dhe iniciativat edukative.
- **Universitetet dhe institucionet arsimore** – mbështesin programet e basketbollit në shkolla dhe kampuse.
- **Shkollat dhe mësuesit e edukimit fizik** – ndihmojnë në integrimin e basketbollit në arsimin bazë.
- **Operatorët e teknologjisë dhe platformave digjitale** – kontribuojnë në zbatimin e sistemeve online, aplikacioneve për biletat, statistikën dhe menaxhimin e ligave.
- **Tifozët, vullnetarët dhe ekipet mjekësore** – përfaqësojnë mbështetjen e vazhdueshme dhe sigurinë për pjesëmarrësit.

Secili grup i interesit ka një rol kyç në funksionimin dhe zhvillimin e basketbollit në Kosovë. Bashkëpunimi i ngushtë, koordinimi dhe komunikimi efektiv me të gjitha këto palë siguron që objektivat strategjike dhe aktivitetet vjetore të FBK-së të realizohen me sukses, duke kontribuar në forcimin e pozicionit të federatës si lider i sportit kosovar dhe në avancimin e zhvillimit të basketbollit në të gjitha nivelet.

---

## SWOT ANALIZA

---

Kjo analizë SWOT siguron një bazë të qartë për identifikimin e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive dhe fuqive të Federatës së Basketbollit të Kosovës. Duke adresuar dobësitë dhe kërcënimet në mënyrë strategjike, FBK forcon pozicionin e saj si lider në zhvillimin e sportit në vend.

### PIKËT E FORTA

- **Popullariteti i basketbollit** – Një nga sportet më të ndjekura dhe më të dashura në Kosovë.
- **Vullneti institucional** – Angazhim i lartë nga FBK për implementimin e Planit Strategjik 2026-2030.

- **Rritje e interesimit për basketbollin** – Rritja e numrit të lojtarëve të rinj dhe përfshirja aktive e komunitetit.
- **Pozicioni i mirë në marrëdhëniet ndërkombëtare** – Imazhi pozitiv i FBK-së në FIBA dhe ndër partnerët ndërkombëtarë.
- **Pjesëmarrje në gara ndërkombëtare** – Përfaqësimi i Kosovës në garat zyrtare të FIBA-s për të gjitha grupmoshat dhe konkurrencat.
- **Kapacitetet administrative** – Zyra Ekzekutive në zhvillim dhe edukimi profesional i stafit të saj.
- **Projektet zhvillimore dhe për qeverisje të mirë** – Projekte që promovojnë sportin e pastër, përfshirjen gjinore dhe zhvillimin e lojtarëve të rinj.
- **Mbështetja e komunitetit** – Një bazë e fortë tifozësh dhe përfshirja aktive e vullnetarëve.
- **Qasja në projekte ndërkombëtare** – Përfshirja në programe si Erasmus+, Jr. NBA dhe FIBA Youth Development Fund.
- **Kapaciteti për të organizuar ngjarje ndërkombëtare** – Përvoja në organizimin e eventeve si FIBA 3x3 dhe FIBA Kampionate Evropiane për gjeneratat e reja.
- **Inovacioni dhe teknologjia** – Zbatimi i platformave online për shitjen e biletave, statistikat dhe menaxhimin e ligave.
- **Eksperiencia në organizimin e projekteve edukative dhe sociale** – Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në programe si “Basketbolla për të gjithë” dhe iniciativat për vajzat dhe gratë në sport.

## PIKËT E DOBËTA

- **Mungesa e infrastrukturës sportive** – Palestra dhe terrene të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e basketbollit në rritje.
- **Varësia nga financimi qeveritar** – Një pjesë e madhe e buxhetit varet nga Qeveria e Kosovës, duke kufizuar fleksibilitetin financiar.
- **Mungesa e trajnerëve të dedikuar** – Numri i trajnerëve, veçanërisht në minibasketboll dhe 3x3, nuk është në nivelin e dëshiruar.
- **Investime të pamjaftueshme tek gjeneratat e reja** – Niveli i ulët i investimeve në programet për të rinjtë nga ana e klubeve.
- **Mungesa e ekspertëve vendorë** – Varësia nga ekspertët ndërkombëtarë për projekte të caktuara.

- **Mungesa e lojtarëve të profilizuar për 3x3** – Profilizimi i lojtarëve për këtë disiplinë është ende në fazat fillestare.
- **Deficiti financiar** – Mungesa e burimeve të qëndrueshme të të ardhurave.
- **Numri i ulët i përfshirjes së vajzave dhe grave në sport** – Ende kërkohet një strategji efektive për të rritur pjesëmarrjen e tyre.
- **Niveli i ulët i përfshirjes së të rinjve në rajone rurale** – Talente të mundshme mbeten të pashfrytëzuara për shkak të mungesës së qasjes.
- **Mungesa e planeve për motivimin e tifozëve të rinj** – Zhvillimi i bazës së tifozëve është një faktor i rëndësishëm për avancimin e sportit.

### MUNDËSITË PËR FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS (FBK):

- **Mbështetja institucionale** – Përkrahje nga institucionet qendrore dhe lokale për projekte dhe aktivitete sportive.
- **Investimi në PR dhe marketing** – Fuqizimi i markës së FBK-së për të rritur të ardhurat dhe vizibilitetin.
- **Digjitalizimi** – Zhvillimi i platformave digjitale për statistikat e ndeshjeve, licencimin e klubeve dhe menaxhimin e aktiviteteve.
- **Shfrytëzimi i teknologjisë për masivizim** – Platforma për trajnime online për trajnerët dhe lojtarët, si dhe transmetime live të ndeshjeve për një audiencë më të gjerë.
- **Zhvillimi i partneriteteve publike-private (PPP)** – Investime në infrastrukturë sportive dhe projekte të tjera zhvilluese.
- **Fuqizimi i basketbollit 3x3** – Potenciali i madh për masivizimin e kësaj discipline në shkolla dhe komunitete.
- **Integrimi i diasporës** – Identifikimi i lojtarëve dhe trajnerëve nga diaspora për përfaqësueset e Kosovës.
- **Komunikimi i strukturuar** – Rritja e bashkëpunimit me grupet e interesit, veçanërisht klubet dhe tifozët.
- **Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave** – Krijimi i programeve të dedikuara për përfshirjen e tyre.
- **Shfrytëzimi i fondeve ndërkombëtare** – Projekte të financuara nga Erasmus+, FIBA dhe programe të tjera për zhvillim të qëndrueshëm.

- **Rritja e interesimit për eventet ndërkombëtare** – Organizimi i eventeve të rëndësishme në Kosovë mund të rrisë të ardhurat, vizibilitetin dhe reputacionin ndërkombëtar.

### **KËRCËNIMET PËR FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS (FBK):**

- **Rritja e konkurrencës nga sportet e tjera** – Konkurrenca me futbollin dhe aktivitete të tjera për vëmendjen e publikut dhe të rinjve.
- **Varësia nga sponsorizimet** – Mosarritja e objektivave të sponsorizimit mund të dëmtojë stabilitetin financiar.
- **Mos-sigurimi i financimit nga qeveria** – Ndryshimet politike mund të ndikojnë në nivelin e mbështetjes financiare.
- **Inflacioni dhe kostot e larta** – Rritja e kostove mund të ndikojë në buxhetin për aktivitete dhe projekte.
- **Pabarazia rajonale** – Disa rajone kanë më pak mundësi për zhvillimin e basketbollit.
- **Ndikimi i pamjaftueshëm i edukimit sportiv në shkolla** – Politikat e dobëta të edukimit fizik mund të ulin interesin për sportin.
- **Ndryshimet e mundshme në politikat fiskale** – Ndryshimet në tatimet ose rregulloret që prekin sponsorizimet sportive.
- **Tendenca në rënien e përfshirjes rinore në sport** – Konkurrenca me aktivitete të tjera, përfshirë teknologjinë dhe e-sportet.
- **Lufta për sport të pastër** – Sfida në përballje me dopingun dhe manipulimin e ndeshjeve.
- **Bashkëpunimi i dobët me mediat** – Mungesa e mbulimit të mjaftueshëm mediatik mund të ndikojë në vizibilitetin e sportit.
- **Zgjedhjet lokale dhe qendrore** – Ndryshimet në strukturat qeveritare mund të ndikojnë në prioritetet sportive dhe burimet financiare, si dhe në bllokimin e palestrave sportive.

---

### **PRIORITETET STRATEGJIKE TË FBK-SË PËR 2026**

---

Në vitin 2026, Federata e Basketbollit e Kosovës synon të përqendrojë përpjekjet e saj në tri nisma kyçe, të cilat do të përcaktojnë drejtimin e zhvillimit të basketbollit në Kosovë për vitet e ardhshme. Këto nisma janë të ndërlidhura me vizionin e federatës për ndërtimin e një baze të qëndrueshme për sportin dhe për të realizuar objektivat afatgjata të zhvillimit.

Nismat kryesore janë të orientuara drejt implementimit të:

- **Plani Strategjik i FBK-së 2026–2030**, e cila përcakton objektivat dhe planet për zhvillimin e përgjithshëm të basketbollit në vend;
- **Strategjisë së zhvillimit të basketbollit 3x3 drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030**, për forcimin dhe masivizimin e kësaj disipline, duke krijuar bazë të fortë lojtarësh të profilizuar;
- **Konceptit “Basketbolli 3.0”**, i cili përqendrohet në inovacion, digjitalizim dhe përfshirje të komunitetit, duke sjellë një qasje moderne dhe gjithëpërfshirëse në zhvillimin e basketbollit.

#### Nisma 1: Strategjia e re e FBK-së 2026–2030

- **Qëllimi:** Konsolidimi i zhvillimit të përgjithshëm të basketbollit në Kosovë dhe arritja e objektivave strategjike afatgjata.
- **Rezultati i pritur:** Hartimi dhe implementimi i planit 5-vjeçar që siguron rritje të qëndrueshme të sportit, forcim të klubeve dhe përfaqësuesve.

#### Nisma 2: Strategjia e zhvillimit të basketbollit 3x3 drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030

- **Qëllimi:** Fuqizimi dhe masivizimi i disiplinës 3x3 në shkolla dhe komunitete.
- **Rezultati i pritur:** Formimi i një baze të fortë lojtarësh të profilizuar, me pjesëmarrje të lartë në konkurrencat kombëtare dhe ndërkombëtare.

#### Nisma 3: Koncepti “Basketbolli 3.0”

- **Qëllimi:** Modernizimi i basketbollit në Kosovë përmes inovacionit, digjitalizimit dhe përfshirjes së komunitetit.
- **Rezultati i pritur:** Platforma digjitale funksionale, rritja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e basketbollit si dhe forcimi i pranisë së FBK-së në media dhe rrjete sociale për të rritur vizibilitetin dhe angazhimin e komunitetit.

---

## OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

---

Federata e Basketbollit e Kosovës mbetet e përkushtuar për të avancuar basketbollin në vend si një aktivitet i dashur dhe gjithëpërfshirës, duke synuar ndikim pozitiv jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

Për vitin 2026, fokus i saj janë nismat që synojnë zhvillimin e përgjithshëm të basketbollit përmes përmirësimit të infrastrukturës, forcimit të klubeve dhe përfaqësueseve, si dhe avancimit të performancës në garat ndërkombëtare. Njëkohësisht, FBK punon për fuqizimin dhe masivizimin e disiplinës 3x3, duke krijuar lojtarë të profilizuar dhe duke rritur pjesëmarrjen e të rinjve dhe komunitetit në këtë format, në përgatitje të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Përveç kësaj, koncepti “Basketbolli 3.0” synon të integrojë inovacionin dhe teknologjinë, duke zhvilluar platforma digjitale, rritur pjesëmarrjen e vajzave dhe të rinjve, dhe forcimin e prezencës së federatës në media dhe rrjete sociale për të rritur vizibilitetin dhe angazhimin e komunitetit.

Këto iniciativa të harmonizuara sigurojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të matshme, ku çdo grup i interesit luan një rol dhe ndihet i rëndësishëm për avancimin e basketbollit në Kosovë.

Federata e Basketbollit e Kosovës synon të avancojë basketbollin në të gjitha nivelet, duke krijuar një bazë të qëndrueshme zhvillimi dhe duke rritur pjesëmarrjen dhe performancën në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Objektivat kryesore janë:

- **Zhvillimi i infrastrukturës sportive** – Sigurimi i palestrave dhe terreneve të mjaftueshme për të gjitha grupmoshat dhe konkurrencat, përgatitja e planeve afatgjata për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në të gjitha rajonet me mbështetje nga Qeveria Qendrore dhe ato lokale.
- **Fuqizimi dhe zhvillimi i klubeve** – Organizimi i seminareve për qeverisje të mirë, marketing dhe planifikim strategjik; digjitalizimi i licencimit dhe raportimit; sigurimi i pajisjeve sportive për klubet.
- **Zhvillimi dhe fuqizimi i Përfaqësuesve të Kosovës** – Përgatitja dhe pjesëmarrja dinjitoze në garat ndërkombëtare, realizimi i kampeve trajnuese dhe programet për lojtarë të profilizuar.
- **Masivizimi i basketbollit 3x3** – Organizimi i turneve në shkolla dhe komunitet, profilizimi i lojtarëve dhe trajnerëve, pjesëmarrja aktive në FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier dhe ngritja e standardeve për këtë disiplinë.
- **Zhvillimi i basketbollit të të rinjve dhe i talenteve të reja** – Identifikimi i talenteve në bashkëpunim me shkollat dhe komunat; fuqizimi i garave për grupmoshat U12, U14, U16 dhe U18; zhvillimi i programeve si Jr. NBA Kosova dhe Mini-Basketbolli.
- **Fuqizimi i pjesëmarrjes së vajzave dhe grave** – Rritja e pjesëmarrjes në klube, krijimi i programeve specifike për vajza dhe gra, trajnimi dhe certifikimi i gjyqtareve dhe trajnereve femra.

- **Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm të edukimit të trajnerëve** – Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për trajnerët, digjitalizimi i burimeve edukative, promovimi i diversitetit dhe certifikimi i trajnerëve në të gjitha nivelet.
- **Rritja e vizibilitetit dhe angazhimit të komunitetit** – Forcimi i prezencës në media dhe rrjete sociale, promovimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve, angazhimi i tifozëve dhe komunitetit për të rritur pjesëmarrjen.
- **Fuqizimi i qeverisjes së mirë dhe integritetit** – Zbatimi i standardeve të qeverisjes së mirë, transparenca në vendimmarrje, lufta kundër dopingut dhe manipulimit të ndeshjeve, përfshirja e grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.
- **Rritja e stabilitetit financiar dhe të ardhurave** – Optimizimi i shpenzimeve operative, sigurimi i partneriteteve publike dhe private, donacioneve ndërkombëtare dhe fondeve për zhvillim, dhe implementimi i strategjive të marketingut për të rritur sponsorizimet.
- **Zgjerimi i komunitetit të basketbollit** – Përfshirja e shkollave, universiteteve, organizatave komunitare dhe diasporës për të rritur pjesëmarrjen dhe zhvillimin e bazës së lojtarëve, trajnerëve dhe tifozëve.
- **Zbatimi i politikave mbrojtëse të dala nga projekti Safeguarding the Future** – Sigurimi që të gjitha masat dhe udhëzimet e projektit Safeguarding të zbatohen në të gjitha aktivitetet e FBK-së, duke mbrojtur lojtarët dhe pjesëmarrësit, veçanërisht grupmoshat e reja, dhe duke krijuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës.
- **Fuqizimi i Shoqatës së Basketbollistëve/eve** – Mbështetje profesionale dhe sociale për basketbollistët pas pensionimit dhe rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe aktivitete të federatës.
- **Rritja e bashkëpunimit me grupet e interesit** – Forcimi i bashkëpunimit me klubet, federatat, shkollat, universitetet, partnerët medial dhe sektorin privat, përmes takimeve periodike, programeve të përbashkëta dhe rrjetit të komunikimit efektiv.

## 1.GARAT E FBK-SË

- Organizimi i garave në kategoritë seniorë (në dy konkurrencat)
- Organizimi i garave në kategoritë e reja (në dy konkurrencat)
- Organizimi i Kupës së Kosovës (në dy konkurrencat)
- Organizimi i Superkupës (në dy konkurrencat)
- Organizimi i garave të veteranëve
- Bashkë-organizimi i garave në kuadër të Ligës Unike me FSHB (në dy konkurrencat)

1.1.Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Organizimi i garave	Nëpërmjet ligave të ndara në kategori dhe në dy konkurrencat	Komesarët e Garave dhe Komisionet	Janar – Dhjetor	- Numri i ndeshjeve të zhvilluara sipas kalendarit zyrtar - Numri i incidenteve/ankesave të reduktuara krahasuar me vitin paraprak	FBK MKRS Sponsorët FIBA

1.2.Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Organizimi dhe mbarëvajtja e mirëfilltë e garave, ngritja e cilësisë, dhe masivizimi i sportit të basketbollit	Klubet Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet Gjyqtarët	Përfshirja e basketbollit nëpër të gjitha regjionet e Kosovës si dhe gjithë përfshirja	Në bazë të informatorëve dhe raporteve të Komisioneve dhe Komesarëve të Garave	Në baza javore, mujore, vjetore.	Bordi i FBK-së

## 2. AKTIVITETET E PËRFAQËSUESEVE TË KOSOVËS

- Pjesëmarrja e Kosova A në parakualifikimet për FIBA EuroBasket 2029;
- Pjesëmarrja e Kosova A Femrat në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Reja në FIBA Kampionate Evropiane: U16, U18 dhe U20 në konkurrencën e meshkujve dhe U16 e U18 në konkurrencën e femrave;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Kosovës në FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueses së Kosovës në garat e e-FIBA.

### 2.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s	Nëpërmjet pjesëmarrjes në këto gara zyrtare	Drejtori i Përfaqësueseve	Janar - Dhjetor	- Kalimi i fazës para kualifikuese Euro-Basket 2029 - Përmirësimi i renditjes ndërkombëtare të Kosovës në FIBA	FBK MKRS FIBA Sponsorët

### 2.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Paraqitja sa më dinjetoze në gara ndërkombëtare dhe synimi për sukses	Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet Stafi teknik	Ngritja e cilësisë tek basketbollistët/ et e reja të Kosovës, por edhe tek trajnerët	Në bazë të raporteve nga trajnerët, udhëheqësit e delegacioneve nëpërmjet Drejtorit të Përfaqësueseve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

### 3. KLUBET DHE ANËTARËT E SAJ

- Fuqizimi dhe digjitalizimi i procesit të licencimit të klubeve;
- Organizimi i tri seminareve për klubet (antidoping, politikat për mbrojtje dhe kundër ndeshjeve të fiksuara, marketingut&vizibiliteti si dhe transparenca dhe qeverisja e mirë)
- Paraqitja e klubeve në garat ndërkombëtare; (dy konkurrencat)
- Shpërblimet e njëjta në dy konkurrencat;
- Donacionet (veshmbathje sportive, topa,);
- Fuqizimi i bashkëpunimit/komunikimit me klubet;
- Organizimi i takimeve në mes klubeve dhe krerëve të FBK-së (para fillimit të edicionit, gjatë edicionit dhe pas përfundimit të edicionit).
- Organizimi i takimeve me palët e tjera të interesit dhe krerëve të FBK-së.

#### 3.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Fuqizimi i klubeve	Seminare, Punëtori, Takime	Sekretari i Përgjithshëm	Janar – Dhjetor	- Minimum 90% e klubeve të licencuara dhe të përmbushin kriteret - Të paktën 80% e klubeve të kenë ekipe zinxhir dhe programe të dokumentuara të zhvillimit.	FIBA; FBK; MKRS; Partnerët/Sponsorët, Projektet e ndryshme Erasmus+

#### 3.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Zhvillimi, fuqizimi dhe ngritja profesionale e klubeve tona	Klubet/ shkolla/ shoqatat/ anëtarët e tjerë	Të kemi klube sa më të strukturuar dhe shembull për qeverisje të mirë, klube që investojnë	Në bazë të raporteve, takimeve, e organizimeve të tjera	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

		në staf teknik dhe administrativ			
--	--	----------------------------------	--	--	--

#### 4. ORGANIZIMI I EVENTEVE DHE AKTIVITETET Tjera

- Organizimi i FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier (dy konkurrencat) në Kosovë;
- Organizimi i FIBA Women's European Championship për Shtetet e Vogla;
- Organizimi i FIBA U18 Women's EuroBasket, Divizioni C;
- Mbështetje dhe asistencë në organizimin e turneve 3x3 në qytete të ndryshme të Kosovës;
- Organizimi i Kuvendit Statutar dhe Kuvendit të Punës të FBK-së;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët/sponsorët e FBK-së;
- Pjesëmarrja me veteranët në aktivitete jashtë vendit;
- Takimi vjetor Shooter - Steering Committee
- Organizimi i punësive për zbatim të Politikave të Mbrojtjes në Basketboll;
- Shpallja e Laureatëve 2026.

4.1. Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Pjesëmarrja e vazhdueshme e FBK-së në organizime të eventeve të FIBA-s Rritja e standardeve për organizim të brendshëm të garave Organizime me karakter vlerësues	Nëpërmjet përgatitjes së punës profesionale	Sekretari i Përgjithshëm	Janar – Dhjetor	- Numri i eventeve të organizuara sipas planit - Pjesëmarrja e target-grupit, rritje e pjesëmarrjes në organizimet e FIBA-s - Përfaqësimi mediatik dhe promovimi	FBK MKRS FIBA Sponsorët

4.2.Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacioni	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Të dëshmojmë profesionalizmin për organizimin e ngjarjeve sportive në vendin tonë dhe të ofrohet mikpritje për të gjithë mysafirët në secilin organizim.	Stafi organizativ dhe grupet e tjera të interesit të përfshira në organizim të eventeve	Të sigurohen të hyra financiare nëpërmjet organizimit Promovim i shtetit	Në bazë të raporteve nga personat përgjegjës në aktivitete që raportojnë tek Sekretarja e Përgjithshme	Në bazë të aktiviteteve/garave, kuvendeve , takimeve dhe organizimeve.	Bordi i FBK-së

## 5.AKTIVITETET E BASKETBOLLIT 3X3

- Organizimi i garave shkollore 3x3, 'Sport në shkollë'-program shtetëror;
- Projekti Alley Oop;
- Organizimi i FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier;
- Pjesëmarrja në gara të FIBA 3x3 në nivel të Përfaqësuesve (meshkuj/femra);
- Profilizimi i basketbollistëve/eve për 3x3;
- Profilizimi i trajnerëve/eve për 3x3;
- Profilizimi i gjyqtarëve për 3x3;
- Bashkëpunimi me promotorë të ndryshëm për organizimin e turneve në qytete të ndryshme të Kosovës;
- Infrastruktura dhe zhvillimi i disiplinës 3x3

5.1. Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Organizimi i garave dhe pjesëmarrja në gara zyrtare të FIBA 3x3	Nëpërmjet bashkëpunimit me grupe të interesit brenda dhe jashtë vendit, propozim për ligë seniore në disiplinën 3x3	Menaxherja e Projekteve	Janar – Dhjetor	- Numri i eventeve të zhvilluara sipas kalendarit - Tajnimi dhe licencimi i trajnerëve/eve dhe gjyqtarëve/eve për 3x3 - Performanca e përfaqësuesve në gara ndërkombëtare FIBA 3x3	FBK MKRS FIBA 3x3 Sponsorët

5.2. Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjësi
- Organizimi sa më profesional i garave dhe paraqitja sa më e mirë për në gara ndërkombëtare - Profilizimi i basketbollistëve/eve	Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet Organizatorët	Zhvillimi dhe fuqizimi i basketbollit 3x3 në vendin tonë	Në bazë të raporteve të Menaxheres së Projekteve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

## 6. AKTIVITETET PËR TRAJNERËT

- Organizimi i edukimeve për trajnerët në bashkëpunim me FIBA-n;
- Organizimi i edukimeve për trajnerët e Mini-Basketbollit;
- Organizimi i seminareve/klinikave para-sezonale;
- Pjesëmarrja në Coaches Observation Trip;

- Pjesëmarrja në FIBA European Womens SUMMIT 2025;
- Pjesëmarrja në FIBA Konventën e Mini-Basketbollit;
- Pjesëmarrja në programin për trajnerë të FIBA-s, FECC;
- FIBA U-14 Get Together

6.1 Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
- Zhvillimi dhe edukimi i trajnerëve kosovarë - Rritja e numrit të trajnerëve të kualifikuar në dy gjinitë.	Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit	Drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore	Janar - Dhjetor	- Numri i trajnerëve të trajnuar dhe certifikuar - Përqindja e trajnerëve të kënaqur me trajnimin	FBK MKRS FIBA Sponsorët

6.2. Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
- Edukimi profesional i trajnerëve - Profilizimi i trajnerëve në disiplina dhe kategori	Trajnerët Drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore	Të kemi trajnerë të edukuar dhe të profilizuar.	Në bazë të raporteve tek Drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore i asistuar departamenti dhe SHTFBK	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

## 7. AKTIVITETET PËR GJYQTARË/VËZHGUES

- Organizimi i FIBA SCOD Klinika para-sezonale;
- FIBA PRNC Klinika;

- FIBA SCOD Kampi;
- FIBA Talent Kamp;
- FIBA 3x3 Gjyqtarët;
- Play-Off Workshop;
- Kampit të gjyqtarëve 3 PO;
- Pjesëmarrja e gjyqtarëve në PNRC Kamp;
- Pjesëmarrja e gjyqtarëve në Scania Cup;
- Klinika për FIBA Referee Instructor;
- Pjesëmarrja e gjyqtarëve kosovarë në ndarjen e drejtësisë në FIBA Kampionate Evropiane të gjeneratave të reja;
- Kampi Veror për gjyqtarë;
- SCOD seminari për gjyqtarë dhe vëzhgues;
- Mbajtja e Klinikës për Statistika Live;
- Mbajtja e Klinikës për DSS;
- FIBA FRIP Level 1;
- Pjesëmarrja e Delegates Teknike në edukime profesionale dhe nominimi në ndeshje ndërkombëtare;
- Vazhdimi i punës me gjyqtarët/delegatët e rinj.

7.1Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Edukimi dhe trajnimi i gjyqtarëve/delegatëve	Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndarje të drejtësisë në gara zyrtare të FIBA-s	Instruktori Nacional i FBK-së	Janar - Dhjetor	- Numri i gjyqtarëve dhe delegatëve të trajnuar dhe të certifikuar - Performanca e personave zyrtarë në ndeshje	FBK MKRS FIBA Sponsorët

7.2.Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Të rritet për çdo vit numri i gjyqtarëve kosovarë me thirrje të FIBA-s dhe profesionalizmi i gjyqtarëve dhe vëzhguesve të rinj	Gjyqtarët Vëzhguesit Tavolina Zyrtare	Të kemi gjyqtarë dhe vëzhgues dhe staf përcjellës cilësorë	Në bazë të raporteve të Instruktorit Nacional si dhe evoluimit personal të gjyqtarëve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

## 8. PROJEKTET ZHVILLIMORE

- 3x3 në shkolla/Programi “Sport në Shkolla”;
- Identifikimi i talentëve U13 në Basketboll për djem dhe vajza;
- FIBA Europe Youth Development Fund (YDF Europe);
- FIBA Europe Girls Program (kampanja Her World, Her Rules);
- Minibasketbolli;
- Jr. NBA Kosova;
- Kampi në Postojna të Sllovenisë.
- Projektet: Shooter, projekt ndërkombëtare në kuadër të Erasmus +.

8.1Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Masivizimi Identifikimi Qëndrimi në basketboll Zhvillimi Organizimi	Nëpërmjet pjesëmarrjes në turne, kampe, klinika, si dhe organizimeve në vendin tonë të aktiviteteve me karakter ndërkombëtar,	Drejtori për Programe dhe Projekte Zhvillimore	Janar – Dhjetor	- Numri i projekteve të realizuara sipas planit dhe afateve - Numri i pjesëmarrësve në projektet e zhvillimore	FBK MKRS FIBA Komunat Sponsorët Erasmus+

	punën në terren me gjenerata e reja me staf teknik profesional				
--	--	--	--	--	--

### 8.2.Kontrolli dhe Vlerësim

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
- Të rritet numri i djemve dhe vajzave që e praktikojnë basketbollin - Të rritet numri i djemve dhe vajzave të moshës prej 5 deri në 13 vjeç që e praktikojnë basketbollin - Të krijohen mekanizma të veçantë dhe të sigurta për qasjen e të gjithë fëmijëve në basketboll	Koordinatorët/et Trajnerët/et Basketbollistët Basketbollistet Palë të tjera të interesit Stafi teknik i angazhuar nga FBK	- Të rritet numri i fëmijëve që e praktikojnë basketbollin dhe të atyre që qëndrojnë në basketboll - Të identifikohen fëmijë potencial - Të krijohet program i veçantë për punën me fëmijët e gjeneratave të reja	Në bazë të raporteve të vazhdueshme tek Drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore  Menaxheres së Projekteve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së

## 9.NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE

- Edukimi dhe zhvillimi i stafit të zyrës ekzekutive në programet e FIBA-s, KOK-ut, KON-it, UEFA/FIFA etj.;
- Përfaqësimi i FBK-së në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
- Organizimi i takimit vjetor të stafit të FBK-së për forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit (team building);
- FIBA Academy Strategic Leaders (FIBA);
- Punëtori për shortin e gjeneratave të reja (FIBA);
- FIBA Time Out 4.0;
- ASMC, Kursi për Administrator, Trajneri sportiv (KOK);
- Wi-Lead (FIBA);
- Basketball for Good;
- Klinika/Trajnim me karakter ligjor;
- Investimi profesional në stafin e Zyrës Ekzekutive (Master në kolegje të Kosovës).

9.1Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Investimi në kuadro dhe kthimi prapa i këtij investimi për zhvillimin e FBK-së	Nëpërmjet pjesëmarrjes në Programe, Punëtori, Klinika dhe Seminare	Sekretari i Përgjithshëm	Janar – Dhjetor	Numri i stafit të trajnuar dhe të certifikuar  Përqindja e pjesëmarrësve që raportojnë përmirësim të aftësive	FBK MKRS FIBA KOK

9.2.Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Të rritet cilësia në administratën e FBK-së dhe më gjerë	Stafi i zyrës ekzekutive, Bordi	Ngritje e profesionalizimit tek Zyra Ekzekutive	Në bazë të raporteve të aktiviteteve tek Sekretarja e Përgjithshme	Në bazë të aktiviteteve	Bordi i FBK-së

## 10. DIPLOMACIA SPORTIVE

- Pjesëmarrja e Kryetarit të FBK-së në mbledhjet e Bordit të FIBA Evropës në cilësinë e anëtarit të Bordit;
- Pjesëmarrja e Kryetarit të FBK-së në takimet e punës të FIBA Europe Youth Commission (Nënkryetar i këtij Komisioni);
- Pjesëmarrja e Sekretares së Përgjithshme në takimet e punës të FIBA Europe Business Development Commission (anëtare e këtij Komisioni);
- Pjesëmarrja e Sekretares së Përgjithshme në takimet e punës të FIBA 3x3 Commission (anëtare e këtij Komisioni);
- Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Europe (Kryetari + Sekretarja e Përgjithshme);
- Pjesëmarrja në takimin vjetor të Sekretarëve të Përgjithshëm të FIBA Evropës;
- Pjesëmarrja në FIBA Academy Strategic Leaders (Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm/ Drejtori i Përfaqësuesve)
- Pjesëmarrja në shortin e Përfaqësuesve të Reja (Drejtori i Përfaqësuesve dhe Drejtoresha e Eventeve);
- Pjesëmarrja në aktivitetet e Përfaqësuesve të Reja;
- Pjesëmarrja në Punëtoritë e Junior NBA (Sekretarja e Përgjithshme dhe Drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore);
- Pjesëmarrja në takimin vjetor të Programi Shooter (Menaxherja e Projekteve + Asistentja Ekzekutive);
- Pjesëmarrja e Zyrtares për Integritet dhe Mbrojtje në takimet e SPOC personave në kuadër të FIBA;
- Pjesëmarrja në klinika dhe punëtori nga FIBA dhe grupe të tjera të interesit.

10.1 Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Udhëtime me karakter të rrjetëzimit	Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete	Sekretari i Përgjithshëm	Janar-Dhjetor	Rritja e vizibilitetit dhe promovimit ndërkombëtar të FBK-së	FBK MKRS FIBA

10.2.Kontrolli dhe Vlerësim					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë sportive	Zyrtarët e FBK-së	Bashkëpunimi me organizata të tjera ndërkombëtare Zhvillimi i projekteve të përbashkëta	Në bazë të raporteve të aktiviteteve	Në bazë të aktiviteteve	Bordi i FBK-së

## 11.AKTET NORMATIVE TË FBK-SË

- Ndryshimet Statutare;
- Përditësimi i Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2026/27;
- Përditësimi i Propozicioneve të Garave të Ligave të Kategorive të Reja, Edicioni 2026/27;
- Përditësimi i Propozicioneve të Kupës së Kosovës;
- Përditësimi i Propozicioneve të Garave për Kategorinë e Veteranëve, Edicioni 2026/27;
- Përditësimi i Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK, Edicioni 2026/27;
- Përditësimi i Rregullores për Licencim dhe Garim në FBK, Edicioni 2026/27;
- Përditësimi i Rregullores Financiare;
- Përditësimi i Udhëzuesve dhe doracakëve sipas nevojës

*\*Përditësimi dhe miratimi i akteve tjera normative sipas nevojës.*

11.1Plani i Veprimit					
Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	KPI	Burime
Përditësimi dhe miratimi i akteve normative të nevojshme për mbarëvajtjen e garave nga komentet e edicioneve aktuale	Nëpërmjet përgatitjes së punës profesionale	Sekretari i Përgjithshëm;	Janar – Dhjetor	Numri i akteve normative të përgatitura, të përditësuara dhe të miratuara sipas kërkesave zyrtare dhe brenda	N/A

dhe ndryshimet e nevojshme përshtatur kohës				afateve të paracaktuara.	
---	--	--	--	--------------------------	--

11.2.Kontrolli dhe Vlerësimi					
Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
Të jemi në hap me nevojat dhe rrethanat aktuale rreth mbarëvajtjes dhe administrimit të garave	Përshtatshmëria e akteve normative me gjendjen dhe rrethanat aktuale në gara/aktivitete Përshtatshmëria e akteve normative me gjendjen dhe rrethanat aktuale në interes të hisedarëve	Zhvillimi sa më i mirë i aktiviteteve të FBK-së	Në bazë të raporteve, rekomandimeve nga Komisionet e FBK-së apo personave të tjerë me interes	Para fillimit të edicionit vijues;	Bordi i FBK-së

## REKOMANDIMET

Rekomandohet që Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës të mbështesë plotësisht realizimin e objektivave të Planit të Veprimit 2026, duke u fokusuar në katër fusha kyçe strategjike:

### 1. Forcimi i sistemit të garave dhe i strukturës së klubeve

- Mbështetja e masave për rritjen e cilësisë dhe profesionalizimit të garave;
- Harmonizimi i sistemit të licencimit dhe i standardeve të klubeve me praktikata më të mira ndërkombëtare;
- Nxitja e zhvillimit të zinxhirit të grupmohave, veçanërisht në klubet e Superligës dhe Ligës së Parë.

**Qëllimi:** një ligë më konkurruese, më transparente dhe më funksionale, që krijon bazë të qëndrueshme për talentet dhe ekipet përfaqësuese.

### 2. Zhvillimi i Përfaqësuesëve dhe investimi në talente

- Miratimi i planit të harmonizuar të zhvillimit të përfaqësuesëve për grupmoshat U14–U20 dhe seniore/seniorë;
- Përforcimi i sistemit të scouting-ut dhe të përgatitjes afatgjate të lojtarëve;
- Rritja e fokusit në përfaqësueset e vajzave, duke krijuar kushte të barabarta zhvillimi dhe pjesëmarrjeje.

**Qëllimi:** Përfaqësuese më konkurruese dhe një model i qartë i zhvillimit të talentit në nivel kombëtar.

### 3. Implementimi i Strategjisë 3x3 dhe Përgatitja për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030

- Zbatimi i planit 3x3 me prioritet: krijimi i bazës së lojtarëve, trajnimi i trajnerëve dhe rritja e aktivitetit në shkolla dhe komunitet;
- Organizimi i eventeve ndërkombëtare FIBA 3x3 si pjesë e pozicionimit të Kosovës në hartën rajonale të 3x3;
- Ndërtimi i kapaciteteve të ekipeve përfaqësuese 3x3 në të gjitha nivelet.

**Qëllimi:** krijimi i një programi 3x3 të qëndrueshëm dhe konkurrues drejt vitit 2030.

### 4. Qeverisja e mirë, integriteti dhe zhvillimi organizativ i FBK-së

- Miratimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave të reja të qeverisjes, integritetit dhe politikave të mbrojtjes;
- Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe gjyqtarëve/trajnerëve përmes programeve të certifikimit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Përforcimi i komunikimit strategjik, bashkëpunimit me grupet e interesit, diplomacisë sportive dhe përfaqësimit ndërkombëtar të FBK-së.

**Qëllimi:** një federatë moderne, transparente dhe në përputhje të plotë me standardet e FIBA-s dhe praktikata më të mira të qeverisjes.

---

## PËRFUNDIM

---

Bordi inkurajohet të miratojë këtë Plan të Veprimit dhe të mbështesë alokimin e burimeve të nevojshme për zbatimin e tij. Realizimi i këtyre prioriteteve do të garantojë progres të matshëm dhe të qëndrueshëm për basketbollin në Kosovë, duke e harmonizuar zhvillimin e vitit 2026 me objektivat e Planit Strategjik 2026–2030 dhe me pritjet e partnerëve vendorë e ndërkombëtarë.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

---

Federata e Basketbollit të Kosovës

